

## **Intervista e Guvernatorit Fehmi Mehmeti për KosovaPress**

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti bën të ditur se parashikimet e BQK-së për këtë vit janë që norma e rritjes ekonomike për sivjet të jetë 6.6 përqind.

Derisa thotë se lehtësimi i masave anti COVID-19 që ndodhen gjatë vitit 2021, bëri që të ketë një rritje të ndejshme ekonomike në vend.

Mehmeti vlerëson se bashkatdhetarët që kanë ardhur këtë verë në Kosovë, kanë shpenzuar mbi 630 milionë euro, teksa tregon se remitencat kanë arrit 651 milionë euro.

Guvernatori Mehmeti në një intervistë për KosovaPress, thotë se Qeveria ka një qasje serioze për anëtarësimin e Kosovës në Kartonin e Gjellbër, por që fillimisht sfidë mbetet numri i madh i automjeteve të paregjistruara në Kosovë.

Përveç Kartonit, sfidë tjetër mbetet edhe shfrytëzimi i platformës së internetit për pagesa elektronike "Paypal", ngase kjo e fundit nuk e njeh Kosovën shtet.

Duke folur për rritjen ekonomike, Mehmeti thotë se në vitin 2020, Kosova kishte një rënie ekonomike 3 përqind për shkak të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

**Guvernatori Mehmeti:** Masat e ndërmarra për parandalimin e pandemisë COVID-19 sikurse në gjithë botën, ashtu edhe në Kosovë ndikuan ose afektuan dukshëm në aktivitetin ekonomik në Kosovë, kështu që viti 2020 në terma real, sipas të dhënave që i kemi, kemi një rënie ekonomike 3 përqind. Mirëpo, relaksimi i masave që ndodhen gjatë vitit 2021, jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet nga vijnë diaspora, bëri që të kemi një rritje të ndejshme ekonomike në vend. Dhe parashikimet tona janë që rritja ekonomike në Kosovë do të jetë 6.6 përqind, edhe pse është subjekt i rishikimit, duke pasur parasysh, deri në fund të vitit se si rrjedh çështja që ka të bëjë me pandeminë, duke pasur parasysh që burim i krizës në Kosovë dhe në nivel global është pandemia dhe jo faktor të tjerë ekonomik. Gjithçka lidhet me pandeminë.

Sipas tij, remitencat nga bashkatdhetarët kanë shënuar rritje 24 përqind, derisa shpenzimet e tyre deri në korrik ishin 140 përqind më shumë se vitin paraprak.

**Guvernatori Mehmeti:** Lehtësimi i kufizimeve të lëvizjes të bashkatdhetarëve nga vendet që vijnë në Kosovë del që të kemi ardhje të shumë bashkatdhetarëve dhe që të kemi një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve jo-rezidente, që ne i quajmë shpenzime të diasporës, të cilat me të dhënat e korrikut, që i kemi ne në dispozicion shënojnë 630 milionë euro apo me një rritje nëse e krahasojmë mbi baza vjetore del të jetë 140 përqind. Por, edhe nëse e krahasojmë me vitin 2019, kemi një rritje rreth 7 përqind. Remitencat vazhdojnë të jenë në rritje, shënojnë 651 milionë euro apo me një rritje vjetore 24 përqind.

Ardhja e diasporës, sipas Mehmetit, ndikoi edhe në rritjen e importit të mallrave në mbi 40 përqind, teksa shton se është rritur edhe vlera e eksporteve në 476 milionë euro, ose 63 përqind më shumë.

**Guvernatori Mehmeti:** Kjo ka bërë të kemi edhe rritje të kërkesave të brendshme në Kosovë gjë që ka qar në rritjen e importit në përqindje rreth 43.4 përqind, duke arrit vlerën 2.9 miliardë euro. Por, gjithashtu kemi edhe rritje të eksporteve, shprehur në përqindje rreth 63.4 përqind ka rritje të

eksporteve që ka arrit vlerën 476 milionë euro. Kjo ka bërë që të thellohet edhe më tutje deficiti tregtar që ka arrit në 2.44 miliardë euro apo me një rritje vjetore prej 40 përqind.

Guvernatori ka folur edhe për rritjen e çmimeve në vend, teksa thotë se inflacioni ka shënuar rritje nga 0.2 në 1.6 përqind, ndërsa investimet e huaja, Mehmeti thotë se kanë arrit 271 milionë euro.

**Guvernatori Mehmeti:** Sa i përket inflacionit nga 0.2 përqind sa ishte një vit më herët, ka shkuar në 1.6 përqind dhe gjithashtu edhe investimet e huaja direkte kanë shënuar rritje nga 201 milionë sa ishin vitin 2020, kanë arrit 271 milionë. Por, kryesisht kemi rritje të investimeve të huaja direkte në sektorin e patundshmërisë, shprehur në përqindje i bie diku rreth 80 përqind në këtë sektor. Ndërkaq, investimet e huaja direkte në shërbimet financiare mbesin të njëjta me vitin e kaluar.

Ani se normat e interesit për kredi shënojnë 6 përqind dhe kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia, vetëm gjatë vitit 2021, bankat komerciale kanë lëshuar kredi të reja 974 milionë euro.

**Guvernatori Mehmeti:** Nëse shohim sektorin bankar si komponent kryesor të sektorit financiar, edhe përkundër rreziqeve të pritura gjatë periudhës së pandemisë, vetëm gjatë vitit 2021, ka arrit të lëshoj kredi të reja 974 milionë euro, gjë që ka bërë që totali i kredive të jetë 3.5 miliardë euro apo me një rritje vjetore prej 12 përqind. Vazhdon të ketë edhe rritje të asetëve. Asetet në sektorin bankar kanë shënuar 5.6 miliardë euro apo me një rritje vjetore rreth 15 përqind...Gjithashtu sektori bankar vazhdon ta ketë besueshmërinë e lartë të publiku, dhe si rezultat i saj kemi rritje të depozitave që kanë arrit të jenë 4.5 miliardë euro me një rritje prej 14.5 përqind. Në anën tjetër norma e interesit në kredi ka rënë në 6 përqind, gjë që ka bërë të lehtësohet qasja në financa.

Në anën tjetër, kreditë joperformuese (kreditë e këqija), edhe pas përfundimit të moratoriumit që ka qenë një periudhë ristrukturimit, prapë se parapë vazhdojnë të mbesin të ulëta, duke shënuar kështu 2.6 përqind.

Guvernatori Mehmeti ka treguar edhe mënyrën e fitimit të bankave në gjysmën e parë të këtij viti që kanë shënuar 55 milionë euro.

**Guvernatori Mehmeti:** Me të dhënat e qershorit, diku rreth 55 milionë euro është fitimi i bankave. Bankat vazhdojnë ta ruajnë atë normën e profitit që realisht e kanë ndër vite dhe realisht kjo nuk është si rezultat i rritjes së normave të interesit, por si rezultat i menaxhimit më të mirë të shpenzimeve ose zvogëlimit të shpenzimeve që bankat janë duke i bërë. Tash, një gjë çka ne e kemi jo vetëm si Kosovë, por edhe në nivel global se edhe prej krize del diçka e mirë. Që në rastin konkret, ne kemi qenë shumë të kujdesshëm në lëvizjen e digjitalizimit të sektorit bankar. Mirëpo, pandemia bëri që ky proces të përshpejtohet. Tash lëvizja drejt digjitalizimit ka bërë që të ulëte kosto, të rritet efikasiteti për klientë, por gjithashtu edhe për bankat.

Sa i përket sektorit të sigurimeve, Mehmeti thotë se ky sektor ka arrit të konsolidohet dhe të jetë profitabil. Në anën tjetër guvernatori shton se për t'u anëtarësuar Kosova në Kartonin e Gjellbër duhet të ullet numri i automjeteve të paregjistruara që ka arrit në 30 përqind.

Mehmeti ka thënë po ashtu se janë në pritje të kompletimit të bordit të BQK-së që nuk është funksional tash 15 muaj.

**Guvernatori Mehmeti:** Vazhdojnë të kenë rritje edhe të pagesës së dëmeve, baza vjetore diku rreth 24 përqind, jo pse ka dëme më shumë se në të kaluarën, por si rezultat i mbikëqyrjes së përafërt që ne si BQK jemi duke bërë këtij sektori. Ky sektor ka arrit të konsolidohet më në fund dhe të jetë profitabil...Tashmë jemi në pritje të kompletimit të Bordit, dhe besoj që kur të kompletohet Bordi i BQK-së, s'e u bën që 15 muaj s'kemi bord funksional, dhe ta aprovojmë këtë Rregullore dhe lëvizim drejt liberalizimit të tregut të sigurimeve në segmentin e sigurimeve të detyrueshme... Qeveria ka nxjerrë vendim dhe është formua një Grup punës, i cili do të merret vetëm me çështjen e Kartonit të Gjëlber, dhe në kuadër të këtij Grupi, të kësaj ekipe është ndër institucional dhe merr pjesë edhe BQK dhe MPB. Dhe akter të tjerë relevant që duhet të jenë pjesë e këtij Grupi, e që besoj se shumë shpejt kjo çështje do të adresohet, duke pasur parasysh që po shihet që kemi një qasje serioze të qeverisë në këtë drejtim. Andaj, fillimisht duhet të adresohet çështja e automjeteve të pasiguruara(ose të peregjistruara) që është shumë e lartë në Kosovë dhe më pastaj të fillohet edhe me aplikim në Këshillin e Byrove.

Mehmeti shtoi se për të pasur Kosova qasje në sistemin e pagave elektronike në "Paypal", kërkohet koordinim ndër institucional, teksa thekson se BQK ka marrë iniciativë në këtë drejtim, përkundër që platforma e internetit "Paypal", nuk e njeh Kosovën si shtet.

**Guvernatori Mehmeti:** Kosova si shtet i ri ka pasur dhe vazhdon të ketë vështirësi për qasje në platformat e internetit. Kjo fillimisht është edhe si pengesë që për një kohë nuk e kemi pasur kodin telefonik. Më pastaj, ne ende nuk e kemi domenin tonë shtetëror. Përkundër kësaj, shumë platforma të internetit Kosovën e kanë përfshirë në listat e saj si shtet, por disa prej këtyre nuk kanë përfshirë që në këtë rast është edhe "Paypal", pasatj, e kemi Samsung Pay, Google Pay. Ne si Bankë Qendrore kemi bërë përpjekje që ta sjellim edhe këtë sistem të pagesave në Kosovë, sikur Paypal, edhe Google Pay, dhe Samsung Pay. E kështu me rend. Kemi bërë aprovimin e një rregullore për regjistrime, që ka të bëjë me institucionet financiare jo bankare, të cilat merren me parat elektronike.

Sa i përket institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare po ashtu, Mehmeti thotë se ka institucione të tilla, të cilat e kanë statutin e OJQ-së, teksa shtoi se këto funksionojnë si institucione financiare bazuar në legjislacionin në fuqi.

Mehmeti e thotë me përgjegjësi të plotë, se nuk ka asnjë problem sa i përket zbatimit të ligjit që ka të bëjë me fushën që ndërlidhet me rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve financiare.

Derisa thekson se në të ardhmen duhet të adresohet çështja e statutit të OJQ-së, e cila duhet të rregullohet me ligjin e OJQ-së.

Në këtë sektor kreditë kanë arrit deri 220 milionë euro, me një rritje vjetore 5-7 përqind, përkundër që normat e interesit në këtë sektor mbesin të larta.

Guvernatori Mehmeti tha se është një sektor që kërkon të rregullohet edhe më shumë në kuptimin legjislativ, duke pasur parasysh këtë, BQK ka përcjellë edhe draft ligjin në Kuvend sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me pagesa, para elektronike dhe çështje të tjera të cilat janë me interes.